



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 93 date 20/12/2002

**PER  
VLERESIMIN ME TITULLIN “QYTETAR NDERI I TIRANES”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “dh” dhe “m”, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Kulturës dhe Arsimit “**Për vlerësimin me Titullin “Qytetar Nderi i Tiranës” të personalitetit të shquar të letrave shqipe Z.Robert SHVARC**”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të vlerësojë **Z.ROBETR SHVARC** me titullin “**QYTETAR NDERI I TIRANES**”, me motivacionin:

**“Për të nderuar ndihmesën e tij të shquar në fushën e letrave, si përkthyes i shkëlqyer dhe shqipëruesi i shkrimtarëve të mëdhenj botërorë, në shërbim të lexuesve mbarë shqipëtarë duke lartësuar e pasuruar vlerat e gjyhës sonë amtare”**

2. Efektet financiare për organizimin e ceremonisë së dhënies së Titullit, sipas pikës 1 të këtij Vendimi, në shumën prej 100.000 lekë, të përballohet nga buxheti i Bashkisë së Tiranës, zëri “projekte kulturore”

3. Ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi
  
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**



